

## STATUTI

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "EL DENT"

### Përkufizime

Në këtë statut termat :

- "Ligji" → është ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
- "Statut" → është statuti "EL DENT" shpk
- "Ditë të plota" → në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

### KREU I

#### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA

##### Neni 1

##### Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më datë 07.07.2024 unë themeluesi kam krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin "EL DENT"
2. Themeluesi i shoqërisë është :

- ▶ Emër, Mbiemër : Elidon Çoniku, ID I 0090907 2 H , Datëlindja 09.09.1980, Atesia Kujtim
- ▶ Forma e shoqërisë : Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
- ▶ Emri ligjor i shoqërisë : EL DENT
- ▶ Adresa e shoqërisë : Rr.S.Bruzi, Nd.111, H.1, Njësia administrat,11, 10 2 6 Tiranë

- ▶ Vendi regjistrimit : Tiranë

##### Neni 2

##### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shitje artikuj mjekësore dhe dentare.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj : Për një periudhë kohore të pakufizuar.

**Neni 4**

**Adresa e faqes së internetit dhe adresa elektronike**

1. Adresa elektronike : Elidonconiku27@gmail.com
2. Numër kontakti: 0694662355

**KREU II**

**KAPITALI I RREGJISTRUAR**

**Neni 5**

**Vlera dhe pagesat e kapitalit të rregjistruar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është : 100 lekë

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtëm :

- ▶ Ortaku themelues : Elidon Çoniku ID:100909072H
- ▶ Lloji i kontributit : LEKË
- ▶ Vlera e kontributit : 100 lekë
- ▶ Numri i kuotave: 1 kuotë
- ▶ Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë : 100 %

Vlera totale e kapitalit të rregjistruar është : 100 lekë

Vlera e paguar është : 100 lekë

2. Kapitali themeltar i shoqërisë është rregjistruar : QKB

**Neni 6**

**Llojet e kuotave, të drejtave dhe kufizimeve**



Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Ortakut të Vetëm.

## Neni 7

### Kalimi i kuotave me trashëgimi ose si pasojë e falimentimit

1. Nëse Ortaku i Vetëm vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët e tij do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij, pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e Ortakut të Vetëm të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm.
2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë rregjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh një person tjetër të rregjistrohet si zotëruar i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
3. Personi tjetër që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruari i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesmarrjes ose të votës, deri në momentin e rregjistrimit në QKB.

## Neni 8

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i Kapitalit Themeltar


1. Shoqëria me vendim të Ortakut të Vetëm mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet edhe me qëllim, pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.
2. Shoqëria me vendim të Ortakut të Vetëm mund të zvogëlojë kapitalin themeltar të shoqërisë

## KREU III

### ORGANET E SHOQËRISË

## Neni 9

### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme



Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- ▶ miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- ▶ shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- ▶ investime;
- ▶ vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.


Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

#### Neni 10

#### Emërimi i administratorit

Shpk "EL DENT" ka si administrator të saj, Ortakun e Vetëm Elidon Çoniku me numër personal ID: I00909072H , atësia Kujtim.

Në pajtim me ligjin, neni 95, pëika 1, afati i emërimit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje duke filluar nga 07.06.2024 - 06.06.2029 .


Emër, mbiemër	Adresa	Specimenti i nënshkrimit
	Rr.S.Bruzi, Nd.111, H.1, Njesia administrat. 11, 1026, Tiranë	

#### Neni 11

#### Kompetencat e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- ▶ kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- ▶ përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- ▶ kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ▶ përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë dhe, së bashku me përdorimin e fitimeve;



## **Prishja dhe shpërndarja**

Prishja dhe shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar, siç mund të jenë :

- ▶ Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të veprimtarisë së saj.
- ▶ Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji Nr.8901, datë 23.05.2002 "Për falimentimin".
- ▶ Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

### **Neni 16**

#### **Likujdimi**

Në rast të likujdimit të shoqërisë, Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim për emërimin e 1 ose disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likujdim e sipër".

Afati i emërimit të likujdatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës, duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Rregjistrit të Shoqërive.

Likujduesi, në përputhje me ligjin dhe me vendimin e Ortakut të Vetëm, mund të shpëmdajë në dobi të ortakut të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri.

### **Neni 17**

#### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 18**

#### **Dispozita përfundimtare**

Ky statut u përpilua në (tre) 3 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, të miratuar në parim dhe nen për nen dhe nënshkruar në të gjitha kopjet, duke vendosur emër, mbiemër dhe firmën e tyre origjinale.

**ORTAKU I VETËM**

